

ARMAND OMERI

**TERMINOLOGJIA GJUHËSORE NË PUNIMET SHKENCORE
PËR KOMPOZITAT (FJALËT E PËRBËRA)**

Në këtë punim jemi mbështetur në kumtesat shkencore për kompozitat, realizuar nga gjuhëtarët: Kostaq Cipo, Aleksandër Xhuvani, Androkli Kostallari, Jani Thomai. Terminologjinë e seleksionuar e kemi konsultuar me fjalorët e termave të gjuhësisë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i termave të gjuhësisë, shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht*, Tiranë, 1975; Giovanni Belluscio, Shezai Rrokaj, *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë (shqip-italisht-frëngjisht-anglisht)*, Arbëria, Arcavacata di Rende - Tiranë, 2011.

Në terminologji për të identifikuar elementet e rrafshit të shprehjes (termat), ku çdo element (çdo term) duhet t'i përgjigjet vetëm një elementi të rrafshit të përmbajtjes (një koncepti), kërkohet që të nisemi gjithnjë nga elementet e përmbajtjes (nga koncepti). Konceptet bëhen bazë e identifikimit të termave të sistemit¹.

Sipas përkufizimit të Kostaq Cipos (1892-1952) “kompozitat janë shprehje lakonike të rastit, miklime e lulëzime të gjuhës, që marrin nga një emër sipas punës që bëjnë në gji të periodës. Kompozitat këpujore (composita copulativa), sanskritisht u thonë Dvandva. Kur ngjiten të dy skajet e një kompozite sine copula, aty kemi dvandva ose shqip: kompozitë këpujore”².

Aleksandër Xhuvani (1880-1961) i quan “fjalë të përngjitura a kompozita”³.

Androkli Kostallari (1922-1992) përkufizon se “fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në shqipen është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformonjëse, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintatike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj”⁴.

Jani Thomai i përkufizon kompozitat si “fjalë të formuara me përbërje ose me përngjitje; janë formuar nga bashkimi i dy ose më shumë temave gjatë krijimit të

¹ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes)*, Shtëpia botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2009, f. 18.

² K. Cipo, *Rreth disa kompozitave*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, f. 61-66 (nxjerrë nga *Buletini i Institutit të Shkencave*, 1948, nr. 1, 2-3).

³ A. Xhuvani, *Kompozitat*, Botim i Akademisë së Shkencave, Vepra 1, Tiranë, 1980, f. 348.

⁴ A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, f. 83.

*fjalëve të reja; pjesët e tyre mund të jenë tema emërore, mbiemërore, foljore ose ndajfoljore, si: zemërgur, belhollë, buzëqesh, keqkuptoj, fjalëshumë etj*⁵.

Studiuesit vlerësojnë se “termi është një tip i veçantë njësie leksikore emërtuese e gjuhës dhe dallohet nga ana e veçorive strukturore, meqë paraqitet në formën e fjalës dhe të togfjalëshit (...), ashtu dhe nga ana përmbajtjesore, meqë shërben për shprehjen e koncepteve shkencore e teknike”⁶; “termat emërtojnë një send ose një nocion në një fushë të caktuar të diturisë a të teknikës”⁷. Gjithashtu në fushën e terminologjisë rëndësi të dorës së parë merr norma terminologjike. Norma terminologjike parakupton një traditë gjuhësore të qëndrueshme që ka tashmë një terminologji të ngulitur. Kjo vlen për pjesën më të madhe të terminologjisë së traditës sonë gjuhësore⁸.

1. Përdorimi i terminologjisë së ngjashme e të ndryshme nga forma dhe nga përmbajtja

Nga inventarizimi i terminologjisë në studimet për kompozitat, studiuesit përdorin terma standardë dhe terma të formuluar prej tyre, nisur nga studimi i thelluar që i bëjnë ata kompozitave në gjuhën shqipe. Ata në përgjithësi përdorin termin standard ose të quajtur ndryshe termin që përbën normë terminologjike: **kompozim, kompozita**.

Kompozita atributive (bahuvrihi, pronare) ndeshet si term i përdorur nga K. Cipo, kurse A. Kostallari të njëjtin nocion e shpreh me termin **kompozita bahuvrihi-emra, kompozita bahuvrihi-mbiemra** ose **kompozita ekzocentrike** (temë e përbërë mbiemërore, *gjaknxehësi, fatkeqësi*); J. Thomai shqipëron fjalën përcaktuese të termit togfjalësh **kompozitë pronësore**; në punimet e mëvonshme A. Kostallari përdor termin **kompozita pronësore**; po kështu e gjejmë dhe në *Fjalorin e termave të gjuhësisë*, Tiranë, 1975: **kompozitë pronore** ose **bahuvrihi** dhe në *Fjalorin krahasues të termave të gjuhësisë*, Tiranë, 2011: **kompozitë pronore**.

Termin **kompozitë asnjane** (*vërej, anembanë*) e gjejmë të përdorur nga J. Thomai dhe në *Fjalorin e termave...*, 1975 e në *Fjalorin krahasues...*, 2011. Termin **kompozita me kuptim abstrakt** (*dorëzani-a nga dorëzanë, dashamirësi-a nga dashamir*) e gjejmë vetëm tek A. Xhuvani; po kështu gjejmë **kompozita aberrante** vetëm në punimet e A. Kostallarit.

Në studimin e A. Kostallarit gjejmë termin **kompozita bisemantike**, term për klasifikimin e kompozitave dëshirore: *gojëlidhur, varrvithisur, flamëngarë, pikërrënë, gojëtharë* “pa gjë në gojë, me gojë të tharë” ose mund të ketë kuptim dëshiror. Ai bën dhe një klasifikim leksiko-gramatikor: **kompozita bisemantike emra** (*gojëmbylluri* (ariu, ujku), *gojëmbërthyeri* (ujku), *gojëmbërthyer*

⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 1984, f. 121.

⁶ A. Duro, *Vep. e cit.*, f. 31.

⁷ J. Thomai, *Vep. e cit.*, f. 206.

⁸ G. Belluscio, S. Rrokaj, *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë (shqip-italisht-frëngjisht-anglisht)*, Arbëria, Arcavacata di Rende - Tiranë, 2011, f. 4.

(milingona); **kompozita bisemantike mbiemra** (*pikërenë* si mbiemër dhe “i raftë pika” si emër me kuptim dëshiror; *pikëmadh-i*, “shi *pikëmadh*”); J. Thomai përdor dhe sqaron kuptimin e termit **kompozita bisemantike** që kanë kuptim të drejtpërdrejtë dhe kuptim të figurshëm; ai nisat nga njësitë frazeologjike në gjuhën shqipe që kanë paralele togfjalëshat e lirë me strukturë të njëjtë, por me kuptim të drejtpërdrejtë, pra, *me kokën ulur* si togfjalësh i lirë me kuptim të drejtpërdrejtë dhe *me kokën ulur* si njësi frazeologjike me kuptim të figurshëm. Prej këtyre dy bazave formohet fjala: *kokulur* 1) me kokën ulur, varur; 2) i bindur, i shtruar; *gojëhapur*, *gojëmbyllur*. A. Kostallari përdor një term antonim me termin “kompozitë bisemantike”: termin **kompozita monosemantike**, term për klasifikimin e kompozitave që kanë vetëm një kuptim: *mospastëpjesi*, *qoftëlargu*, *ndeshtrasha*, *largneshi*, *kryeshëndoshë*, *ndjesëpasti*; këtë term e gjejm vetëm tek ky studiues dhe në asnjë nga materialet e marra në shqyrtim. Termin **kompozitë e cunguar**, me përjashtim të dy fjalorëve të marrë për krahasim, nuk e gjejmë të përdorur në studimet e marra në analizë.

K. Cipo përdor termin **kompozitë determinative**; A. Kostallari përdor termin **kompozitë determinative jo-ekzocentrike**, por ky i fundit e shqipëron elementin e dytë të togfjalëshit terminologjik dhe krijon termin **kompozitë përcaktuese**, ashtu si në *Fjalorin e termave...*, 1975 dhe në *Fjalorin krahasues...*, 2011.

K. Cipo është thelluar më tej në studimin e kompozitave determinative dhe krijon termin me tri gjymtyrë në përbërje të tij: **kompozita determinative ndajshimore** (në sanskritisht: *Karmadharaya*): *kryeqytet* “një qytet që është krye” *krye-plak*, *Shën-gjergj*; **kompozita determinative mvartëse** (*Tatpurusha*).

J. Thomai përdor termin **kompozitë dëshirore**, kurse A. Kostallari studion fjalët e përbëra dhe sqaron termin e përdorur në hulumtimet e tij: **kompozita dëshirore** (deziderative) shprehin një dëshirë ose një cilësi që dëshirohet ta kenë qeniet a sendet që ato emërtojnë e përcaktojnë ose të cilave ato u referohen: *gojëmbylluri*, *gojëmbërthyeri*, *gojëthati*, *gojëlidhuri*, *faqezi*, *jetëgjatë*, *këmbëmbarë*, *ditëzi*, *ditëzezë*, *derëzi*, *derëzezë*. Ai i klasifikon më tej këto kompozita dhe krijon terma, që i emërtojnë nocionet me më shumë gjymtyrë, nocioni ngushohet, emërtimi bëhet edhe më i përpiktë, si: **kompozita dëshirore-pronësore**, **kompozita dëshirore-jopronësore** (*ndjesëpasti*, *mospastëpjesi*); **kompozita disfemizma** ose **kakofemizma** quan kompozitat që përdoren për të lëshuar nëma a mallkime dhe këta terma janë sinonimë me termin “kompozita dëshirore”: *gojëmbylluri*, *qafëthyeri*, *qoftëlargu*, *largneshi*; **kompozita eufemizma** që përdoren për të marrë me të mirë, për të përkëdhelur forcat e këqija; është term sinonim me termin “kompozita dëshirore”: *shpirtndrituri*, *ndjesëpasti*, *dritëpasti*, *shtozovallet*, *ndjezoti*, *eshtralulëzuari*). J. Thomai përdor termin **kompozita eufemistike** ku gjymtyra e dytë e termit togfjalësh është mbiemër, ndërsa termi togfjalësh i A. Kostallarit ruan marrëdhënie përcaktore-ndajshimore, e ngjashme për nga fjalëformimi me një kompozitë. Norma terminologjike duhet të vendosë në rastet e termave sinonimë. Për të zgjedhur termin e përshtatshëm do të marrim parasysh disa kushte, si konceptin që shpreh termi, përdorimin e shpeshtë nga shumë studiues dhe aftësinë termformuese.

Termin **kompozitë dëshirore** nuk e gjejmë në dy Fjalorët që na shërbejnë si material krahasues.

Termin **kompozitë këpujore** e gjejmë në të dy fjalorët krahasues; e gjejmë në punimin e K. Cipos së bashku me termin e huaj: *composita copulativa*, sanskritisht *Dvandva*; e gjejmë dhe në punimin e A. Kostallarit. Ky studiues **kompozitat këpujore** (kopulative), përmes studimit më të thelluar i klasifikon edhe më tej në **kompozita urdhërore këpujore** duke krijuar një term me tri gjymtyrë ose krijon termin me katër gjymtyrë **kompozita urdhërore me komponentë homogjenë: deleduk** “del e duku”, *digjepiq*, *Matepre*, *Kapethe*. Në termin **kompozita urdhërore** (imperative) studiuesi përfshin disa fjalë të përngjitura, të formuara me anë të aglutinimit të fjalive urdhërore..., kryesisht me anë të substantivimit, si: *shtojzovallet*, *hajujk-u*, *shtroerë*. Tek punimi i J. Thomait gjejmë termin **kompozita urdhërore**, por pa u ndalur në shtjellim më të thelluar; kurse në dy fjalorët e marrë për krahasim këtë term nuk e gjejmë.

Studiuesit K. Cipo dhe A. Xhuvani në studimet e tyre për kompozitat i kanë parë ato nga vlera semantike dhe për këtë kanë krijuar dhe kanë përdorur terma me tri gjymtyrë. K. Cipo studion fjalët e përbëra dhe përdor termat: **kompozita me kuptim të fytyruar** (confabulatio): *thashë e themë*, *thana thaça*, *thana thusha*, *këmb’e krye*, *këmb’e kokë* që përdoren si adverbe dhe me kuptimin e fytyruar..., *nat’e ditë* (nox cum die). Sot teoria e fjalëformimit i klasifikon këto ndërtime si fjalë të përngjitura; **kompozita me kuptim të njëjtë**, që për nga konceptimi dhe shembujt e dhënë del term sinonim me termin “kompozita me kuptim të fytyruar” *thashë e themë* (dixi et dico), *thana thaça* (dixerunt et dixi), *thana thusha*; **kompozita me kuptim metaforik**.

Studiuesi A. Xhuvani studion dhe zbërthen kuptimin e fjalëve të përbëra dhe mbi këtë bazë krijon dhe terminologjinë. Ai përdor termin **kompozita me kuptim abstrakt** (*dorëzani-a* nga *dorëzanë*, *dashamirësi-a* nga *dashamir*; **kompozita me kuptim mbiemri** dhe sjell shembuj nga N. Frashëri: *zemërgur*, *gojëshpatë*, *shpirtkazëm*. A Xhuvani klasifikon kompozitat që përdoren si mbiemra duke krijuar dhe përdorur këta terma: **kompozita me kuptim cilësie** (*dashamirësi-a* nga *dashamir*); **kompozita me kuptim mohor** (a negativ): (*fatpadale*, *buzëpaqeshur*, *flokëpakrehur*, *fytyrëpalarë*). **Kompozita me kuptim vendi** (*rrobaqepësia*), por A. Xhuvani nuk e pranon një kompozitë të tillë me këtë kuptim.

Studiuesi J. Thomai përdor termin **kompozita mbiemërore**, sinonim me termin “kompozita me kuptim mbiemri” të A. Xhuvanit; **kompozita ndajfoljore**, sinonim me termin “kompozita me kuptim të fytyruar” të K. Cipos. Kurse A. Kostallari përdor termin **kompozita verbale**, **kompozita nominale**, ku fare mirë mund të zëvendësohet gjymtyra e dytë me termin shqip “kompozita foljore”, “kompozita emërore”.

Në dy fjalorët terminologjikë gjejmë termin e njëjtë **kompozitë pronore** ose **bahuvrihi**. K. Cipo përdor terminologjinë e huaj **kompozita atributive (bahuvrihi)** (pronare): *gushëkuq* a *gushakuq*, *mëndje-shumë*, *fjalë-shumë*; *zemër-madh-e*.

Në studimin e J. Thomait gjejmë termin sinonim **kompozita pronësore** (*e ka zemrën gur – zemërgur; e ka kokën të fortë – kokëfortë*). Dhe në studimin e A. Kostallarit gjejmë termin e njëjtë **kompozita pronësore** që në shqipe përfaqëson atë tip kompozitash indoeuropiane, që është quajtur nga gramatikanët indianë *bahuvrīhi*. Ai thellon studimet në fushën e kompozitave dhe sjell terma tri gjymtyrësh. Kështu gjejmë termin **kompozita pronësore-metonimike** ku shohim se sendi, kafsha ose bima emërtohen nëpërmjet një pjese të saj; e tëra shënohet nëpërmjet pjesës (*bishtgërshërë, këmbëqiri, buzëmushkë*); **kompozita pronësore metonimike-metaforike** janë kompozita me pronë të pashënuar drejtpërsëdrejti, por të zëvendësuar metaforikisht (*bishtdhelpe* “bimë me fletë si bisht dhelpe”, *kryekuq* “bimë kënetash”, *sygjarpën* “bimë, lulet e së cilës i ngjajnë syrit të gjarpërit”); **kompozita pronësore-sinekdokore**; nga shpjegimi dhe shembujt ky term ka të njëjtin kuptim me termin “kompozita pronësore-metonimike” dhe mendojmë se klasifikimi i kompozitave dhe përdorimi i termave do të përcaktohen nga konteksti.

Termet e ndërtuar me më shumë se dy gjymtyrë e që në përbërje të tyre kanë sintagmën “*me kuptim*”, mund të zëvendësohen me terma dygjymtyrësh, ku gjymtyra e dytë do të ketë funksion përcaktori të shprehur me mbiemër dhe që do të ruajnë kuptimin e nocionit që emërtojnë. Sa më shumë gjymtyrë të ketë një term, aq më i ngushtë është koncepti që ai emërton, aq më në thellësi është bërë klasifikimi i termave. Ky thjeshtim në ndërtimin e termit na ndihmon që të bëjmë dhe klasifikimin e kompozitave sipas vlerës leksiko-gramatikore. Këta terma i gjejmë në punimet e K. Cipos dhe të A. Xhuvanit. Termet te punimi i K. Cipos janë: **kompozita me kuptim të fytyruar, kompozita me kuptim metaforik, kompozita me kuptim të njëjtë**. Termet te A. Xhuvani janë: **kompozita me kuptim mohor** (a negativ), **kompozita me kuptim vendi, kompozita me kuptim abstrakt; kompozita me kuptim cilësie**. Shembujt që sjell autori tregojnë se termi “kompozita me kuptim cilësie” është sinonim me termin “kompozita me kuptim abstrakt”, kështu që njëri nga termat mund të shmanget nga përdorimi.

Studiuesit kanë klasifikuar kompozitat dhe mbi këtë bazë kanë krijuar terma duke u nisur dhe nga përbërja strukturore e kompozitave (fjalë të përbëra). Në studimin e K. Cipos kemi gjetur termin **kompozita me folje të njëjtë** (*thashë e themë, thana thaça, thana thusha; kompozita me dy gjymtyrë* (ndajshimorë dhe mvarhtëse si *kryeqytet, kryeplak, gjysma-zot, buzë-burbuqe, lule-lakër, dele-dash*). Në punimin e A. Kostallarit gjejmë termat: **kompozita me zanore lidhëse** (*o/a*) (*fatakeq, gushakuq, mollakuq, bishtatundës, djegagur, gushtovjeshtë*); **kompozita pa zanore lidhëse** (*o/a*) që sipas autorit është një nga treguesit formalë më të qartë të fjalës së përbërë, e cila karakterizohet negativisht jo nga prania, por nga mungesa e kësaj zanoreje; **kompozita me strukturë të përzier; kompozitë me tmesis** e cila është një kompozitë me përngjitje, ku midis dy komponentëve kryesorë “shtoju vallet” ka hyrë një element ndarës “zot” e ndonjëherë “zotynë” (*shtojzovalle, mbyllizogojën*); **kompozita dygjymtyrëshe** (*shpirt-e-zemërmadh, leshra-cullufedredhur*). **Kompozita këpujore** (kopulative: *deleduk* “del e duku”, *digjepiq, Matepre*), të cilin e gjejmë edhe te K. Cipo, edhe në të dy fjalorët e marrë

për krahasim, kurse te J. Thomai koncepti emërtohet me termin e shqipëruar: **fjalë të përbëra lidhëzore** (kopulative).

Përveç termit “*kompozitë*”, gjuhëtarët A. Kostallari dhe J. Thomai kanë përdorur në punimet e tyre dhe termin e shqipëruar “*fjalë e përbërë*” dhe për këtë do të mund të flasim në një punim tjetër.

2. Analiza strukturore e termave

Termet që kemi vjelë në punimet shkencore të gjuhëtarëve do t’i shohim dhe nga një aspekt tjetër, nga struktura leksiko-gramatikore.

Termi paraqitet si fjalë dhe si togfjalësh; termi është një njësi leksikore që shpreh një koncept special, është një njësi leksikore speciale jashtë çdo konteksti⁹, kështu që në togfjalëshat terminologjikë koncepti shprehet me një kuptim më të ngushtuar: *kompozitë* – *kompozitë atributive*, *kompozitë determinative*, *kompozitë nominale*, *kompozitë verbale* etj; elementet përcaktuese *atributive*, *determinative*, *nominale*, *verbale* i japin termit formim semantiko-gramatikor; veçojnë secilin nga termet si njësi më vete; kështu fjalët përcaktuese tek termet togfjalësh dalin në rolin e *mjeteve termformuese*.

Formimi i termave mbështetet jo vetëm në mënyrat e zakonshme të formimit të fjalëve, siç janë prejardhja, përbërja apo kompozimi, por dhe në mënyrat sintaksore, ku si mjete termformuese shërbejnë fjalët dhe lidhjet e tyre, p.sh: *kompozitë* + *këpujore* = *kompozitë këpujore* etj. Kështu togfjalësimi është një mënyrë e krijimit të termave, pasi leksiku terminologjik përpiket që të shprehë koncepte sa më të përpikta. Po ta krahasojmë me fjalën, koncepti i shprehur nga termi është gjithnjë më i ngushtë se koncepti i shprehur nga fjala dhe në procesin e zbërthimit të mëtejshëm të konceptit vëllimi i tij vjen gjithnjë duke u ngushtuar¹⁰, si p.sh., “*fjalë* - *fjalë e përbërë* - *fjalë e përbërë emërore* - *fjalë e përbërë emërore me kuptim vepruesi*.”

Pas një termi ngulitet një koncept i caktuar. *Tipari i ngulitjes* së konceptit në sistemin e termave u shërben gjuhëtarëve si kriter për të përcaktuar nëse një njësi terminologjike, që del në formën e një togfjalëshi të zgjeruar duhet pranuar si term, duhet përfshirë në fjalor a duhet lënë jashtë si togfjalësh i lirë. Tipari i ngulitjes është një tipar i termit togfjalësh, por jo i domosdoshëm, sepse ka edhe njësi të tjera të leksikut që janë të ngulitura, por që s’janë terma, si *pallat kulture*, *gur mulliri* etj.¹¹. Ngulitja e koncepteve në njësi të tilla togfjalëshash të zgjeruar, si: *fjalë të përbëra lidhëzore*, *fjalë të përbëra përcaktore*, *fjalë të përbëra mbiemërore*, *fjalë të përbëra foljore*, *kompozita me zanore lidhëse*, *kompozita pa zanore lidhëse*, shërbejnë si kriter për t’i cilësuar këto njësi si terma. Tek togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë gjymtyra kryesore mbart konceptin, kurse gjymtyra e varur përcaktuese plotëson kuptimin e konceptit dhe të dyja shndërrohen në njësi emërtuese të një koncepti, tiparet e të cilit pasqyrohen gjuhësisht përmes togfjalësimi, p.sh., *kompozitë shumëgjymtyrëshe*, *kompozita*

⁹ A. Duro, *Vep. e cit.*, f. 32.

¹⁰ A. Duro, *Vep. e cit.*, f. 50.

¹¹ A. Duro, *Vep. e cit.*, f. 51

pronësore metonimike, fjalë të përbëra mbiemra bisemantike etj. Këta terma togfjalësh do t'i përfshijmë në fjalorët terminologjikë duke i vlerësuar nga konceptet që emërtojnë, nga gjerësia dhe denduria e përdorimit në gjuhë. Në procesin e standardizimit të terminologjisë të gjithë gjuhëtarët ngulmojnë për të shmangur sinoniminë absolute apo dysorët terminologjikë. Sistemet terminologjike nuk e pranojnë dukurinë e sinonimisë absolute; sistemet terminologjike kërkojnë nëpërmjet një pune hulumtuese terma sa më të qartë, sa më të motivuar kuptimisht; kërkojnë saktësi në përzgjedhjen e kuptimeve nga struktura kuptimore e fjalëve të leksikut të përgjithshëm, me qëllim që fjala dhe kuptimi i përzgjedhur të ngrihet në nivelin e termit dhe të normë terminologjike. Me normë gjuhësore kuptohet tërësia e rregullave që përcaktojnë përdorimin e mjeteve të gjuhës letrare në mënyrë të njëlojtë për të gjithë pjesëtarët e një kombi; përdorimi i mjeteve gjuhësore që është ngulitur e është pranuar nga të gjithë pjesëtarët e një kombi si në ligjërimin e folur ashtu edhe në atë të shkruar¹². Në këtë kuptim duhet të flasim dhe për një normë terminologjike.

Po të shikojmë fjalorët terminologjikë në përgjithësi dhe ata gjuhësorë në veçanti, janë përfshirë si terma vetëm njësitë emërtuese me gjymtyrë kryesore emra. Dhe togfjalëshat terminologjikë kanë si tipar të përbashkët funksionin emërtues; ata shërbejnë për të shënuar dukuri të realitetit shkencor gjuhësor apo të shkencave të tjera. Ata paraqiten si njësi të mëvetësishme, kanë një kuptim, prandaj në fjalorin terminologjik të një dijeje të caktuar duhet të të pasqyrohen si njësi më vete.

Në gjuhën e përgjithshme fjala është baza për zhvillimet semantike të saj, po ashtu dhe konteksti i përdorimit; kështu dhe për terminologjinë bazën e çdo formimi e përbën termi njëfjalësh. Prandaj nga gjuhëtarët ai mendohet si parësor në raport me togfjalëshin terminologjik.

Duke parë gjymtyrët përbërëse të togfjalëshave terminologjike në fushën e kompozitave, veçojmë këto struktura dhe modele me bazë emërore. Tipat kryesorë janë:

1. Emër + emër: këtë model të togfjalëshit terminologjik e gjejmë vetëm te studiuesi A. Kostallari: *kompozita disfemizma* ose *kompozita kakofemizma*, *kompozita eufemizma*. Madje këtë strukturë mund ta klasifikojmë si *termformim me kompozim me marrëdhënie përcaktore-ndajshimore* dhe ku elementi përcaktues mund të zërthehet me fjali: *kompozita disfemizma* zërthehet "*kompozita që janë disfemizma*".

2. Emër + mbiemër: ky është modeli më i zakonshëm për krijimin dhe ndërtimin e togfjalëshave terminologjike. E gjejmë tek K. Cipo: *kompozita këpujore*, *kompozita atributive*, *kompozita determinative*; e gjejmë në punimet e A. Kostallarit, nga ku kemi veçuar *kompozita aberrante*, *kompozita ekzocentrike*, *kompozita nominale*, *kompozita verbale* etj.; në punimin e J. Thomait kemi veçuar

¹² *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980, f. 1270.

kompozita pronësore, kompozita urdhërore etj.; dy fjalorët terminologjikë kanë renditur vetëm këtë model togfjalëshi terminologjik.

3. Emër + mbiemër + mbiemër: ky është modeli i togfjalëshit terminologjik me tri gjymtyrë; te K. Cipo gjejmë *kompozita determinative ndajshtimore, kompozita ndajshtimore mvarëse*; te A. Kostallari kemi gjetur *kompozita pronësore metonimike, kompozita dëshirore pronësore, kompozita urdhërore këpujore*.

E ngjashme me këtë strukturë është dhe modeli emër + mbiemër + emër, i cili mund të shprehet sipas modelit emër + mbiemër + mbiemër, p.sh., *kompozita bisemantike emra* mund të zëvendësohet me “kompozita bisemantike emërore”, *kompozita bisemantike mbiemra* mund të zëvendësohet me “kompozita bisemantike mbiemërore” etj.

4. Emër + parafjalë + emër: ky model i termit togfjalësh haset në *Fjalorin e termave...*, Tiranë, 1975 dhe në *Fjalorin krahasues të termave...*, Tiranë, 2011, p.sh., *kompozitë me bashkërenditje, kompozitë me nënrenditje, kompozitë me pranëvënie* (juxtaposed), *kompozitë me takim*; ndërsa te A. Kostallari gjejmë *kompozita me strukturë të përzier, kompozita me zanore lidhëse (o/a), kompozita pa zanore lidhëse (o/a)*; gjejmë dhe një term të veçantë për një tip kompozite të veçantë, *kompozita me tmesis*.

5. Një grup të veçantë të togfjalëshit terminologjik krijojnë termat që në strukturën e tyre kanë fjalën “me kuptim”. Terminologjinë me këtë strukturë e gjejmë te punimi i K. Cipos: *kompozita me kuptim të ftyruar* (confabulatio), *kompozita me kuptim metaforik, kompozita me kuptim të njëjtë*. Terminologjinë me këtë strukturë e gjejmë dhe në punimin e A. Xhuvanit: *kompozita me kuptim abstrakt, kompozita me kuptim mbiemri, kompozita me kuptim cilësie, kompozita me kuptim mohor, kompozita me kuptim vendi*, të cilët mund të zëvendësohen me terma togfjalështa me dy gjymtyrë, p.sh., “kompozita të ftyruara ose të figurshme”, “kompozita metaforike”, “kompozita njëkuptimëshe”, “kompozita mbiemërore” etj. Duke qenë se termi ka dhe funksion klasifikues, mendojmë se këtë funksion klasifikues e kryen më së miri fjala “me kuptim” dhe kjo na lejon të pranojmë se termat e mësipërm duhet të jenë pjesë e fjalorëve të termave të gjuhësisë.

BIBLIOGRAFI

- A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes)*, Shtëpia botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2009.
- A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972 (Studime filologjike, 1968, nr. 4).
- A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, (BUSHT, SSHSH 1962, nr. 3).
- A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, (BUSHT, SSHSH, 1961).

Terminologjia gjuhësore në punimet shkencore për kompozitat...

- A. Kostallari, *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, (Konferenca e parë e Studimeve albanologjike, T. 1965).
- A. Xhuvani, *Kompozitat*, Botim i Akademisë së Shkencave, Vepra 1, Tiranë, 1980 (artikull i vitit 1952; nxjerrë nga A. Xhuvani, “*Studime gjuhësore*”, 1956).
- F. Leka, *Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe*, SF, 1985/1.
- Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980, f. 1270.
- Fjalor i termave të gjuhësisë, shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht*, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1975.
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1976.
- G. Belluscio, Sh. Rrokaj, *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë (shqip-italisht-frëngjisht-anglisht)*, Arbëria, Arcavacata di Rende - Tiranë, 2011.
- H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në vitet '80-të të shek. XX*, Tiranë, 2005.
- H. Pasho, *Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë*, SF, 1985/4.
- J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 1984.
- K. Cipo, *Rreth disa kompozitave*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972. (nxjerrë nga Buletini i Institutit të Shkencave, 1948, nr. 1, 2-3).
- L. Dodbiba, *Vërejtje rreth pastrimit të terminologjisë*, BSHSH, Botim i Institutit të Shkencave, nr. 2, Tiranë, 1956.

